



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 12/26
Datë: 23.04.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 23 të Ligjit Nr. 05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 prill 2020, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Emërohen anëtarët e Komisionit Komisionit për kompensimin e Viktimave të Krimit në këtë përbërje:
 - 1.1. Ariana Shaikovci, Prokurore e Shtetit, anëtare;
 - 1.2. Donika Kadaj-Bujupi, Deputete e Kuvendit të Republikës së Kosovës, anëtare;
 - 1.3. Xhavid Gashi, Ekspert mjekësor, nga Oda e Mjekëve e Kosovës, anëtar;
 - 1.4. Shukrije Statovci, Eksperte mjekësore, nga Oda e Mjekëve e Kosovës, anëtare;
 - 1.5. Valbona Çitaku, Përfaqësuese nga Shoqëria Civile, anëtare.
2. Anëtarët e Komisionit nga pika një (1) e këtij vendimi emërohen me mandat tre (3) vjeçar.
3. Të emëruarit nga pika një (1) e këtij vendimi kryejnë detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara me Ligjin Nr. 05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit dhe legjislacionin përkatës në fuqi.
4. Obligohet Ministria e Drejtësisë për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë